REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-1596/3
Data / Datum / Date: 25 / 03 / 2026
Shtojca / Dodaci / Annex: -2-
PRISHTINË/A (2025)

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Drejtësisë – MinistarsvoPravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministarke Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 44 /2026
Datë: 25.03.2026

Në mbështetje të nenit 9, 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 6 të Rregullores (QRK) - Nr.04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, si dhe në pajtim me nenin 8 (paragrafi 1) të Udhëzimit Administrativ MD-NR. 09/2019 për kushtet e zyrës noteriale, hapësirat dhe pajisjet, Zëvendëskryeminstrja dhe Ministrja e Drejtësisë nxjerr:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni për verifikimin e gjendjes së lokaleve dhe pajisjeve të zyrave noteriale, në këtë përbërje:

   1.1. Burbuqe Spahija-Kërveshi, Zyrtare e Lartë Ligjore – Kryesuese;
   1.2. Muhamet Krasniqi, Zyrtar i Lartë Ligjor - Anëtar;
   1.3. Bekim Basha, MPB - Anëtar.

2. Komisioni nga pika 1 e këtij vendimi obligohet që të vërtetoj gjendjen faktike dhe juridike të zyrës noteriale, të përgatisë procesverbalin për secilën zyrë noteriale dhe të paraqes rekomandimin për pajtueshmërinë e lokaleve dhe pajisjeve të zyrës në pajtim me kriteret e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ MD-NR. 09/2019 për kushtet e zyrës noteriale, hapësirat dhe pajisjet.

3. Me hyrjen në fuqi të vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 392/2025, i datës 03.10.2025 dhe Vendimi nr. 409/2025, i datës 19.11.2025.

4.Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Donika Gërvalla- Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë

Vendimi u dërgohet:

- *Kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit;*
- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Sekretares së Përgjithshme;*
- *Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë Profesione të Lira dhe Statistika;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*